



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 19

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

Prishtinë, më 30 shtator 2015, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Adem Hoxha.

Mungoi: Shukrije Bytyçi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri;
3. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të projektligjit për shëndetin mendor;
4. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Besa Baftiu – Propozoj që si pikë e veçantë e rendit të ditës të jetë diskutimi i Komisionit për marrëveshjen e nënshkruar me 25 korrik 2015 nga kryeministri Isa Mustafa, marrëveshje e cila përveç që prekë sovranitetin e shtetit, prekë edhe shumë sektorë e ndër ta edhe atë të shëndetësisë. Pika 4 d. ka të bëjë me sektorin e shëndetësisë, ku thuhet se „asociacioni do të ushtrojë mbikëqyrje të plotë në shërbimin shëndetësor primar, sekondar dhe në përkujdesje sociale”. Kjo pik qartë e përcakton se ky asociacion ka kompetenca ekzekutive në sektorin e shëndetësisë. Të gjithë e dimë se nivelin sekondar e menaxhon Ministria e Shëndetësisë, por

me këtë marrëveshje është bërë ndarje etnike e shëndetësisë, pra ndarje të spitaleve në serbe dhe shqiptare. Si Komisioni i shëndetësisë duhet të reagojmë për këtë marrëveshje dhe për këtë ndarje.

Njomza Emini -Të vazhdojmë me rendin e ditës, e në pikën të ndryshme mund të diskutojmë këtë çështje.

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri;

Kryetarja –Si Komisioni kemi punuar mjaft në këtë Projektligj, i kemi propozuar amendamentet tona dhe të njëjtat i kemi miratuar.

Raportin me Amendamente e kemi përcjell tek katër komisionet e përhershme, nga të cilat nuk kemi pranuar asnjë vërejtje lidhur me amendamentet tona. Atëherë sot si komision do të diskutojmë dhe miratojmë raportin përfundimtar për Projektligjin.

Komisioni, pas diskutimeve njëzëri miratoi raportin përfundimtar për Projektligjin për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri.

3. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Projektligjit për shëndetin mendor;

Kryetarja -Si Komisioni edhe në këtë Projektligj kemi punuar mjaft. I kemi propozuar amendamentet tona dhe të njëjtat i kemi miratuar.

Raportin me Amendamente e kemi përcjell tek katër komisionet e përhershme, nga të cilat nuk kemi pranuar asnjë vërejtje lidhur me amendamentet tona dhe sot si komision do të diskutojmë dhe miratojmë raportin përfundimtar për Projektligjin.

Besa Baftiu – Propozoj që amendamenti 11, që ka të bëjë me nenin 13 , paragrafi 1.2. që rregullon institucionin përkatës të psikiatrisë forenzike, të zëvendësohet me Instituti i Psikiatrisë Forenzike apo të rregullohet me Ligj të veçantë.

Kryetarja- Edhe komisioni ka diskutuar shumë këtë çështje, por kemi menduar që me këtë ligj të quhet Institucioni përkatës i psikiatrisë forenzike, ndërsa me Ligj të veçantë ta emërtojnë sipas nevojës , pra nuk ndalohet të rregullohet me ligj të veçantë.

Besa Baftiu – Megjithatë jam kundër paragrafit 1.2. të nenit 13, dhe kundër amendamentit 11 të Komisionit.

Komisioni, pas diskutimeve njëzëri miratoi raportin përfundimtar për Projektligjin për shëndetin mendor;

4. Të ndryshme.

Kryetarja – Për këtë pikë, vetëm po ju njoftoj se në fillim të javës që vjen Komisioni do të realizojë një vizitë pune në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu kemi marrë ftesën nga Banka Botërore për të diskutuar për pushimin e lehonisë.

Besa Baftiu – Si pikë të veçantë e propozova që të diskutohet për marrëveshjen me Serbinë e sidomos në pikat që prekin shëndetësinë.

Fikrim Damka – Disa çështje janë të rregulluara edhe në ligjin e shëndetësisë sepse shëndetësia primare dhe sekondare janë në kompetencë të komunave.

Besa Baftiu – Megjithatë mendoj se tani me këtë marrëveshje janë marrë kompetencat e Ministrisë së Shëndetësisë të parapara me Ligjin e shëndetësisë.

Fadil Beka – Jam kundër që spitalet të menaxhohen nga Ministria, mendoj se edhe spitalet të menaxhohen nga komunat.

Kryetarja – Me funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore, nuk do të ketë dy sigurime shëndetësore, një për serbë dhe një për shqiptarë, por do jetë fondi i përbashkët për të gjithë.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA